

STATUT

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" ALBSOLAR " Shpk

Durrës më 14/Janar /2022

Kapitulli I EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Forma

- 1.1. Shoqëria *" ALBSOLAR "* Shpk është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me 2(dy) ortak themelues, dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Emri

Emri i Shoqërisë është: *" ALBSOLAR "* Shpk.

Neni 3 - Objekti

- 3.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj :

Veprimtari private ne fushen e ndertimin e linjave lektrike te TN, TM, TU mbi tokesore (ajrore) dhe nentokesore (kabllore) per energji elektrike dhe telekomunikacioni, nenstacionet elektrike TN/TM dhe te tensionit te mesem TM/TU (kabina elektrike), centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike, energji te rinovueshme nga dielli, ajri dhe gazi (panele diellore fotovoltaike, eolike, bio gaz), objekte civile dhe industriale.

Realizimi I impianteve te telekomunikacionit. Studim dhe projektim per makineri elektrike dhe te linjave te ndryshme industriale.

Mirembajtje, remont profilaktik te mesem e kapital te transformatorve elektrik te çdo lloji, makinave elektrike, pajisjeve elektrike, impiante fotovoltaike dhe impiante eolike. Import- Eksport te materialeve elektrike, telekomunikacionit, sistemeve te alarmit, te vjedhjeve dhe kundra zjarrit, mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, tregtimin e mallrave te gatshem dhe gjysem te gatshem. Tregtimi i paisjeve telefonike te llojeve tendryshme si dhe aksesori per ta. Realizim te impianteve per mbrojtjen kunder zjarrit. Realizim te sistemeve te sigurise elektronike dhe sistemeve te alarmit. Studim, projektim dhe realizim te impianteve elektrike civile dhe industriale. Studim, projektim dhe realizim te impianteve fotovoltaike dhe eolike, civile dhe industriale.

Konsulence, revision, ekspertize te projekteve te zhvillimit dhe te studimeve te besueshmerise se efektiviteteve ekonomike, percaktimin e prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise, kryerjeve, provave dhe matjeve laboratorike.

Import-Eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve me shumice dhe pakice. Tregtim artikuj industrial.

Tregtim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to. Tregtim pajisje elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, telekomunikacionit etj.

Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.

- 3.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- 3.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

- 3.4. Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultat i, apo që ka lidhje me objektin e saj.

Neni 4 - Selia

- 4.1. Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: Durrës adresa e sakte si edhe është ne Vertetimin hipotekor Lagja 10, Rruga Taq Dafa, nr.6, Durrës. Zona Kadastrale nr.8512, Nr.Pas. 14/201, Volumi 33, Faqe 63. Ortaket mund të vendosin të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 - Kohëzgjatja

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të ortakeve themelues.

Neni 6 - Përgjegjësitë

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaket në emrat e tyre personal ndaj personave të tretë.

Kapitulli II KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7 - Kapitali

Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është: **2.000.000,00** (dymiljon) lekë.

Neni 8 - Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

- 8.1. Kapitali është i përbërë nga 2,00 kuota kapitali, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara, me vlerën prej **1.000.000 ,00** lekë secila.
- 8.2. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë zotërohen nga ortaket themelues si më poshtë:

- z. Hajdar KURTI zotëron 50 % kuota të kapitalit, ID: G70105160U
 - z. Eriol KARRULI zotëron 50 % kuota të kapitalit, ID: I60410103O
- te barabarta keto me me 100% të kuotave kapitalit të Shoqërisë.

Neni 9 - Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Ortaket themelues me vendim asambleje mund të rrisin pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
- 9.2. Administratori njofton për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.
- 9.3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 10 - Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

- 10.1. Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, ortaket themelues mund të vendosin ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
- 10.2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.
- 10.3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 11 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 11.1. Ortaket themelues mund të reduktojnë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 12 - Transferimi i kuotave të kapitalit

Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht.

Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III

ORTAKET THEMELUES, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14 - Të drejtat dhe detyrimet

Ortaket themelues janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin, shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 - Procesverbalet

Të gjitha vendimet e ortakeve themelues regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të shoqërisë.

Neni 16 - Hetimet e posaçme

Ortaket themelues mund të vendosin nisjen e një hetimi të posaçëm, për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 17 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

Ortakët themelues kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 92 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 18 - Administrimi

18.1. Shoqëria administrohet nga administratorët. Ortakët themelues kanë emëruar si Administratorë

* z.Eriol KARRULI

për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

18.2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët themelues;
- b) përfaqësojnë Shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.3. Ortakët themelues mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

Neni 19 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi.

Administratori përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV
SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 20 - Shpërndarja e fitimeve

Ortakët themelues kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Kapitulli V
PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 21 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve themelues;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
- d) me vendim të gjykatës;

Ky Statut hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

Lexuar, nënshkruar

ORTAKET E SHOQËRISË

z. Hajdar

KURTI



z. Eriol

KARRULI

